

Drejtoria Arsimore e Filadelfias

Zyra e Edukimit Parashkollor

Klasat e Kopështit dhe të Fillestarëve deri te ata të Klasës së 1rë

Të gjitha Programet e Kopështit janë me Ditë të Plotë

Orët e Kopështit: Kodi rregullator i shtetit, që trajton punën në kopësht, vlerëson që klasat me ditë të plotë të kopështit duhet të bëjnë së paku pesë (5) orë mësimi çdo ditë, 900 orë gjatë 180 ditëve të një viti. Në se kjo kërkesë nuk plotësohet nga secili kopësht, Drejtoria Arsimore mund të humbasë subvencionet e saj.

Mosha

- Pranimi në kopësht bëhet nëse fëmija arrin moshën 5 vjeç, në ose përpara 1 Shtatorit.
- Pranimi në klasën e 1^{te} bëhet nëse fëmija arrin moshën e detyrueshme 6 vjeç, në ose përpara 1 Shtatorit.
- Aplikimi duhet të shoqërohet në çdo rast me prova të shkruara të moshës së fëmijës.
- Provat e pranueshme të moshës (njëra si më poshtë):
 - Çertifikata zyrtare e lindjes; çertifikata e pagëzimit; pasaporta për nxënësin e lindur jashtë Amerikës, dokumenta të tjera (letrat e adoptimit, të dhëna nga gjyqi, të dhëna nga spitali, të dhëna nga shtëpia e fëmijës, nga agjensi të shërbimit social, numri për qytetarë e huaj, numri I-94, si dhe të dhënat e fundit të vaksinimeve .
- Çdo fëmijë 6-vjeçar, që nuk ka frekuentuar kopështin, mundet të regjistrohet në kopësht në vend të klasës së parë, me kërkesën me shkrim të prindërve.

Identifikimi

- Patenta e automjetit/dokument identifikimi nga zyra e patentave.
- Kartë identifikimi e punësimit lëshuar nga Federali, Shteti ose Bashkia.
- Pasaportë

Vendbanimi

- Fëmija duhet të regjistrohet në shkollën që përfshin vendbanimin (shkolla e lagjes) edhe nëse ai nuk mund të ndjekë mësimet në këtë shkollë për arsye të ndryshme, si nevoja speciale, paaftësi, transferim, ose rrethana të tjera të arsyeshme.
- Fëmija duhet të banojë në të njëjtën lagje ku është shkolla, që ai aplikon.
- Në çdo rast, prova me shkrim të vendbanimit duhet të shoqërojnë aplikimin.
- Provat e pranueshme të vendbanimit (njëra si më poshtë):
 - Fatura aktuale e shërbimeve elektrike, ujit, gazit (PECO, PGW, water), karta e votimit, kontrata origjinale e qeramarrjes/qeradhënies (të jetë e shtypur, e firmosur dhe e noterizuar), tapia e shtëpisë, qëndrimi si mik e firmosur nga pronari/qeramarrësi dhe e noterizuar, do të pranohen si prova të vendbanimit edhe letra nga shtëpia e fëmijës dhe DHS, kur nxënësi që do të regjistrohet është nën kujdesin e shtëpisë së fëmijës dhe agjensi që kujdesen për fëmijët, si dhe vendbanimet që përcaktohen për nxënësit e pastrehë.

Si rrjedhojë e Ligjit Federal – Plyer kundër Doe [457 US 202 (1982)] – shkollat nuk mund të refuzojnë pranimin në shkollë të një nxënësi, bazuar në statusin që nuk ka dokumente. Ky ligj aplikohet për nxënësit, që nuk janë qytetarë të SH.B.A.